



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUÇOVË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Datë 16 . 06 .2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Pjesë këmbimi goma dhe bateri” (furnizim-vendosje)”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Goma për automjete të lëhta Kodi 34351000-2,

Vajra karburanti Kodi 09135000-4,

Vajra motorike Kodi 09211100-2,

Filtra vaji Kodi 42913300-2,

Filtra nafte Kodi 42913400-3,

Filtra ajri Kodi 42514310-8,

Filtra Kodi 42996700-1.

VLERA E FONDIT LIMIT : 1 714 900 (një milion e shtatëqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh, të vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kuçovë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

Sipas kushteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

2.1.1. Ofertuesi duhet të paraqesi Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 si dhe vitin 2023 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, r, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë në emër të vet për objektin e prokurimit, që vërteton cilësinë e menaxhimit të cilësisë, **ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij**. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që ofertuesit duhet të jenë të certifikuar për cilësinë si dhe të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë.

Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe certifikata ekuivalente të ISO 9001:2015, e cila i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me sukses dhe në kohë.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë që ka në pronësi/ me qira ose kontratë bashkëpunimi 1 pikë servisi brenda juridiksionit të bashkisë Kuçovë (e verifikueshme nga KVO në ekstraktin e QKB-së në mënyrë elektronike).

- Të ketë jo më pak se dy ura në servis (të paraqiten foto);
- Në rast të disponimit të pikës së servisit në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e tij
- Ndërsa për pikën e servisit të marrë me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/ bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të pikës 4 dhe 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur për të shmangur kostot shtesë të autoritetit kontraktor si (karburant, kohë, burime njerëzore etj).

Mjetet e renda në pronësi të autoritetit kontraktor, përdoren për hapjen e kanaleve vaditës dhe kullues në të gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë. Ato përdoren edhe për hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve në kodra me qëllim ardhjen në ndihmë banorëve për vjeljen e ullinjve.

Si dhe mjeti Bulldozer me nr shasie VAUZ0992VZT010091 Model Liebherr LR 634 përdoret në venddepozitimin e mbetjeve urbane, i cili merret gjithë kohës me sistemimin e mbetjeve.

Vonesa që do të shkaktonte ndërrimin e vaj filtrave do të sillte kosto për autoritetin kontraktor të cilat do të reflektoheshin në shërbimet që marrin qytetarët.

Këto mjete, janë me orë pune, dhe ndërrimi i vaj filtrave do të kryhet sa here plotësohen orët e punës.

Lidhur me kriterin që servisi duhet të disponojë dy ura, njësia e prokurimit gjykon se disponimi i dy urave garanton AK për zbatimin e kontratës duke mos sjellë vonesa në ndërrimin e vaj filtrave për mjetet e mëposhtme, se herë që AK ka nevojë.

Prandaj, kriteri i distancës kërkohet për shkak të specifikës së objektit të prokurimit (të cilat janë mjete të rënda si dhe 1 prej tyre është mjet me zinxhir), pasi kontraktimi me një pikë servisi më të largët nuk do të ishte eficient për AK, dhe nuk do të arrihej qëllimi i këtij të fundi.

Kontraktori do të kryej dhe shërbimin e ndërrimit të vaj filtrave për mjetet e tjera në pronësi të AK, si Land Rover (Range Rover Sport)” viti i prodhimit 2008 Nr shasie

SALLSAA748A165407, Opel Antara 2.2 Naftë 2013 Nr shasië WOLLH6H8CB040261, FORD KUGA Fuoristrade me nr shasië FORXXGCDR8S80709 .

2.2.4 Ofertuesit duhet të paraqesin edhe deklaratat si më poshtë:

- a) Fletë garancinë e mallrave ose deklaratë, ku të deklarohej marrja përsipër e garancisë së mallit prej jo me pak se 1 (një) vit nga momenti i vënies në punë.
- b) Ofertuesi duhet të deklarojë se merr përsipër shërbimet për ndërrimin e vaj filtrave për mjetet në pronësi të Bashkisë Kuçovë dhe riparimet e tyre pranë servisit (sipas pikës 2.2.3 të deklaruar prej tyre).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

2.3.5 Ofertuesi duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në orën 8 në datën e hapjes së ofertave mostra të mallrave si më poshtë :

- *Nga 1 (një) mostër për të gjitha filtrat e kërkuar në DST.*
- *Nga 1 (një) litër minimumi, për vajrat për secilin mjet.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 gërma a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin mostra të mallrave të kërkuar nga AK.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit arsyeton se është e rëndësishme për autoritetin kontraktor kërkesa për mostrat e mallrave për vajrajt dhe filtrat. Duke qënë se këto mallra kanë rëndësi të veçantë për mirëfunksionimin e mjeteve të rënda, AK kërkon garanci nga ofertuesit që ti paraqesin ato në përputhje me specifikimet teknike si dhe kodet përkatës të mjeteve, duke garantuar vazhdimësinë si dhe duke mos sjellë vonesa në procesin e ndërrimit të tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

➤ Të dhënat e automjeteve janë si më poshtë:

1. Land Rover (Range Rover Sport) viti i prodhimit 2008 Nr shasië SALLSAA748A165407
2. Opel Antara 2.2 Naftë 2013 Nr shasië WOLLH6H8CB040261
3. Eskavator me goma JCB, viti i prodhimit 2007 me Nr shasië JCBJW14DE71314323
4. Volvo ECR 88 viti i prodhimit 2016, me nr shasië 16682
5. FORD KUGA Fuoristrade FORXXGCDR8S80709 (3 ndërrime)
6. Mjet Bulldozer me nr shasië VAUZ0992VZT010091 Model Liebherr LR 634 (venddepozitimi mbetjeve urbane)

Materialet dhe pjesët e këmbimit që do të përdoren për riparimin e automjeteve duhet të jenë origjinale të markës së automjetit (*ose ekuivalent i saj*), të cilësisë së parë dhe të sigurojnë një afat garancie të paktën 1 (një) vit nga dita e kryerjes së riparimit (shërbimit).

Lidhur me pjesët e këmbimi për automjete, në mënyrë specifike **Gomat** duhet të jenë të reja (të pariveshura), në sipërfaqet anësore, çdo gomë duhet të ketë të stampuara këto të dhëna:

- Prodhuesi (marka)
- Emërtimi i gomës
- Data e prodhimit, të jenë të prodhimit jo më herët se 12 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
- Gomat e një dimensionit të jenë të gjitha të të njëjtit tip prodhimi/të të njëjtës markë.
- Gomat duhet të jenë prodhim konform standardit CE.

Lidhur me Filtrat:

- Të jenë prodhim sipas standarteve të C.E.
- Duhet të kenë barkodin identifikues në etiketë dhe të jenë origjinale ose ekuivalent i tyre për mjetet e kërkuara sipas specifikimeve teknike.

Ambalazhimi dhe marketimi për vajrat :

- Të jenë prodhim sipas standardeve të C.E.
- Ambalazhimi të bëhet në ambalazh të përshtatshëm për ruajtjen dhe transportimin e mallit.
- Ambalazhi të jetë metalik ose plastik.
- Vajrat e kërkuara të mos jenë të rigjeneruara.

NJËSIA E PROKURIMIT